

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CONSULTING HOUSE” shpk

KREU I

Dispozita të Përgjithshme

Sot me datën 07 Mars 2023 unë i nënshkruari Elton Muça, i biri i Selfo i datëlindjes 06 Mars 1976 lindur në Memaliaj dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor e me zotësi të poltë për të vepruar mbajtës i kartës së identitetit me numër personal H60306133K me vullnet të plotë e të lirë dhe iniciativë të lirë në cilësinë e “Ortakut Themelues” i mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodi Civil, Ligji Nr.9901 datë 04.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” dhe ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare te Biznesit” vendosa të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “Consulting House” shpk.

KREU II

**EMËRTIMI, FORMA LIGJORE, ORTAKËRIA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË,
KOHËZGJATJA DHE SELIA**

Neni 1

Emërtimi

1.1 Shoqëria e themeluar sipas këtij akti mban emrin “Consulting House” Shpk

Neni 2

Forma Ligjore

2.1 Shoqëria “Consulting House” Shpk themelohet si një shoqëri tregëtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar”, shkurtimisht Shpk.

Neni 3

Ortaku i vetëm themelues

3.1 Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë është **Z. Elton Muça**

Neni 4

Ortakët e shoqërisë

4.1 Shoqëria është themluar nga një ortak i vetëm, z. Elton Muça



4.2 Z. Elton Muça, si ortak i vetëm përgjigjet për humbjet e shoqërisë deri në vlerën e kapitalit themeltar të saj

Neni 5

Objekti i Veprimitarisë

5.1 Shoqëria “Consulting House” do të ketë si objekt veprimitarie:

Shërbime konsulence financiare dhe fiskale. Shërbime të kontabilitetit dhe tatimore. Mbajtje kontabiliteti dhe përgatitjen e pasqyrave financiare. Konsulencë për plane biznesi dhe rritje kapacitetesh manaxheriale ne sektoret finance, banke, tregetise, sherbimit, bujqesise, agroturizmit, ndertimit, etj. Shërbime të konsulencë ekonomike dhe agroekonomike. Shërbime ndërmjetësimi lidhur me shit-blerje të ndryshme, punësime, qiramarje etj. Shërbime trainimi financiare, kontabiliteti, fiskale, bankare, manaxheriale, e të tjera në fushën ekonomike. Studime të ndryshme profesionale dhe të tregut në fushën e ekonomise. Cdo veprimtari ekonomike e ligjshme që vlerësohet fitimprurëse për shoqërinë.

Neni 6

Kohëzgjatja

6.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshojë sipas vendimit të ortakut të vetëm të përcaktuar në këtë statut.

Neni 7

Selia e shoqërisë

7.1 Selia e shoqërisë “Consulting House” do të jetë në Tiranë në adresën : Rruga Kongresi i Manastirit, Kompleksi Zirkon, Hyrja E, Nr. 1/1, Njësia Bashkiake Nr.3, Tiranë

7.2 Gjatë veprimitarisë së saj shoqëria ka të drjejtë të krijojë dhe hapë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

KREU III

KAPITALI dhe KUOTAT

Neni 8

Kapitali i shoqërisë

8.1 Kapitali i rregjistruar i shoqërisë “Consulting House” shpk është 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë i barabartë me 1(një) kuotë.

8.2 Kontributet e Ortakëve përbëjnë kapitalin e rregjistruar.

8.3 Pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin e shoqërisë është në raport me kontributin e derdhur prej tij dhe vlera nominale e kuotës të secilit ortak llogaritet në raport me secilin kontribut e paraqitur në mënyrë të përbledhur sipas tableës më poshtë:

Nr	Emri i Ortakëve	Kuota	Kontributi i Ortakëve në kapital (Lekë)	Përqindja në kapital
1	Z. Elton Muça	1	50,000	100%
	Totali	1	50,000	100%

8.6 Kontributet sa më sipër janë nënshkruar dhe depozitohen për llogari të shoqërisë në të gjitha bankat që ndodhen ne territorin e Shqipërisë.

Neni 9

Rregjistrimi i kuotave të kapitalit themeltar

9.1 Kuotat dhe zotëruesi i tyre, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me kuotat e kapitalit themeltar, rregjistrohen në një rregjistër të posacëm

9.2 Format dhe modalitetet e tjera të rregjistrat miratohen me vendim të ortakut të vetëm.

9.3 Në rast të zotërimit të kuotave të shoqërisë nga më shumë se një oratk forma dhe modalitetet e tjera të këtij rregjistri miratohen me vendim të ortakëve që zoterojnë më shumë se $\frac{3}{4}$ e kuotave.

Neni 10

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me vullnet të ortakut

10.1 Ortaku i vetëm mund të transferojë lirisht tek të tretët, pjesërisht ose tërësisht, pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë nëpërmjet:

- a. kontributit ne kapitalin e shoqerise,
- b. shitblerjes;
- c. trashegimise;
- y. dhurimit;
- d. cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

10.2 Në rast se në një moment të caktuar pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë zoterohen nga më shumë se një ortak, transferimi i këtyre pjesëve Brenda shoqërisë mund të bëhet lirisht, ndërsa transferimi tek personat e tretë mund të bëhet vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesëve të kapitalit themeltar.

Neni 11

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi

11.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen lirisht dhe pa asnjë klauzolë kufizuese në këtë Statut, nëpërmjet trashëgimisë, si dhe midis bashkëshortëve në rast ndarje pasurore.

11.2 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen lirisht dhe pa asnjë klauzolë kufizuese në këtë Statut, midis bashkëshortëve si dhe midis prinit dhe fëmijës ose anaselltas.

Neni 12

Akti i transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar

12.1 Në cdo rast transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me vullnetin e ortakut duhet të vërtetohet nëpërmjet një akti notarial

12.2 Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar pasqyrohen në rregjistrin e posacëm të miratuar sipas nenit 9 të këtij Statuti. Mospagimi i transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar në këtë rregjistër, nuk e bën të pavlefshëm aktin e transferimit.

12.3 Akti i transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar duhet të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit jo më vonë se një muaj nga data e rregjistrimit të këtij akti në zyrën notieriale.

12.4 Kërkesa për depozitimin e aktit të shitjes së pjesëve të kapitalit themeltar mund të bëhet nga shitësi ose nga blerësi, ose prej përfaqësuesve të tyre të autorizuar.

Neni 13

Zmadhimi i kapitalit me kontribute në para

13.1 Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet me kontribute në para me vendim të ortakut të vetëm.

13.2 Zmadhimi sipas pikës 1 të këtij nenit bëhet me shlyerjen tërësisht të vlerës së shtuar prej ortakut të vetëm.

13.3 Shlyerja e fondevë mund të vërtetohet nga një zyrë notierale ose nëpërmjet një konferme bankare

13.4 Në rast se zmadhimi i kapitalit nuk kryhet Brenda 6 muajve nga data e depozitimit të fondevë, ortakut të vetëm i lind e drejta të tërheqë fondet e depozituara.

Neni 14

Zmadhimi i kapitalit me anë të kontributave në natyrë

14.1 Zmadhimi i kapitalit themeltar nëpërmjet kontributeve në natyrë bëhet me vendim të Ortakut të vetëm.

14.2 Vlera e kontributit në natyrë si shtesë e kapitalit themeltar përcaktohet nga një ekspert, i cili emërohet nga Ortaku i vetëm.

Neni 15

Zvogëlimi i kapitalit

15.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të ortakut të vetëm duke respektuar në cdo rast minimumin ligjor të kapitalit themeltar.

15.2 Vendimi përkatës pasqyrohet në Statut si dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përndryshe është i pavlefshëm

15.3 Nëse e cmon Ortaku i vetëm mund të caktojë një ekspert kontabël për të verifikuar procedurat dhe aktin e vlerësimit.

KREU IV

ORGANET DREJTUESE DHE TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË

Neni 16

Organet drejtuese

16.1 Organet drejuese të shoqërisë “Consulting House” shpk janë:

- a. Ortaku i Vetëm
- b. Administratori

Neni 17

Ortaku i vetëm, kopetencat

17.1 Ortaku i vetëm ka këto kopetenca

- a. Ndryshimi i dispozitave në statut
- b. Caktimi dhe shkarkimi i administratorit
- c. Caktimi dhe shkarkimi i ekspertit/ekspertëve kontabël si dhe likuidatorit/likuidatorëve
- d. Miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit
- e. Miratimi i raportit vjetor
- f. Shpërndarja e dividentëve
- g. Ndryshimi i kapitalit themeltar

- h. Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar tek palët e treta
- i. Likuidimi dhe/ose shndërrimi I shoqërisë në një formë tjeter

Ortaku i vetëm veç sa parashikohet në pikën 1 të këtij nenit ka të gjitha të drejtat dhe kopetencat në lidhje me administrimin e shoqërisë me përjashtim të atyre që ky Statut ia njeh dhe ja ngarkon Administratorit

Neni 18

Administratori

18.1 Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të vetëm

18.2 Në aktin e emërimit përcaktohet dhe periudha e qëndrimit në detyrë. Në rast se kjo periudhë nuk është përcaktuar në aktin e emërimit atëherë ajo në cdo rast nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet nga dita e emërimit në detyrë.

18.3 Administratori i parë i shoqërisë Consulting House shpk është z. Elton Muça, , i biri i Selfo i datëlindjes 06 Mars 1976 lindur në Memaliaj dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor e me zotësi të poltë për të vepruar mbajtës i kartës së identitetit me numër personal H60306133K, i cili emërohet për një periudhë prej 5 vitesh nga momenti i rregjistrimit të këtij fakti në Qendrën Kombëtare të Biznesit

Neni 19

Kopetencat e administratorit

19.1 Administratori i shoqërisë ka këto kopetanca

- a. Përfaqëson interesat e shoqërisë në raport me të tretët
- b. Përgjigjet për administrimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë
- c. Nënshkruan marrëveshje në emër dhe për logari të shoqërisë sipas përcaktimeve në këtë statut
- d. Përgatit reportin vjetor të administrit të shoqërisë, inventarët dhe llogaritë vjetore
- e. Emëron dhe shkarkon personelin e shoqërisë
- f. Të tjera të parashikuara në këtë statut

Neni 20

Të drejtat dhe detyrimet e administratorit

20.1 Administratori është i detyruar të zbatojë këtë statut si dhe cdo akt tjeter të Ortakut të vetëm që lidhet me veprimtarinë dhe aktivitetin e shoqërisë

20.2 Administratori do të drejtojë dhe të përfaqësojë shoqërinë përsa i përket administrit të zakonshëm

20.2 Do të hapë llogari bankare në emër të shoqërisë në cdo bankë të nivelit të dytë që kryen aktivitetin në Shqipëri ose jashtë saj



- 20.4 Adminisitratori është i detyruar të paraqesë raporte dhe informacione mbi ecurinë e aktivitetit të shoqërisë minimum çdo tre muaj dhe në cdo rast me kërkesë të Ortakut të vetëm
- 20.5 Administratorit i ndalohet shitja dhe blerja e pasurive të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, nëse nuk ka një autorizim me shkrim të Ortakut të vetëm.
- 20.6 Administratori nuk mund të marrë hua në emër të shoqërisë pa një autorizim me shkrim të Ortakut të vetëm ku të jetë specifikuar emri i bankës, institucionit finanziar ose të tretëve dhe garancitë që do të sigurojnë këtë kredi.
- 20.7 Administratori është i detyruar të vërë në dijeni Ortakun e vetëm për cdo akt-marrëveshje të nënshkuar në emër dhe për llogari të shoqërisë menjëhere.
- 20.8 Administratori është i detyruar që të ruajë dhe të respektojë cdo të dhënë që lidhet me aktivitetin ekonomik dhe finanziar të shoqërisë, me përjashtim kur këto të dhëna kërkohen nga organe ligjzbatuese në zbatim të ligjit. Gjithashtu atij i ndalohet të përdorë për qëllime të tij ose të tretëve, njoħuri ose informacione të cilat i ka patur për shkak të ushtrimit të detyrës së Adminisitratorit të shoqërisë.

Ortaku i vetëm në bazë të një vendimi të marrë prej tij ka të drejtë të ngrëjë padi përpara gjykatës kopetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorit si pasojë e shkeljeve të rënda të ligjit apo statutit.

Neni 21

Procedurat e emërimit dhe shkarkimit të Administratorit

- 21.1 Akti i emërimit dhe shkarkimit të Administratorit duhet të jetë me shkrim dhe duhet të përcaktojë periudhën për të cilën është emëruar Administratori, pagën etj.
- 21.2 Me emërimin e administratorit midis tij dhe Ortakut të vetëm nënshkruhet një kontratë punësimi në të cilën parashikohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë
- 21.3 Adminisitratori mudn të shkarkohet në rast se ai përmbrush detyrimet që rrjedhin për të nga ky statut, kontrata e punës si dhe cdo akt tjeter ligjor dhe nënligjor që lidhet me funksionet e tij
- 21.4 Adminisitratori mund të shkrakohet edhe kur humbet besimin e ortakut të vetëm
- 21.5 Akti i shkarkimit të Administratorit duhet të jetë me shkrim dhe duhet të përbajë shkaqet e shkarkimit
- 21.6 Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit mbarojnë menjëherë me Aktin e shkarkimit

Neni 22

Personeli i shoqërisë

- 22.1 Personeli punonjës i shoqërisë emërohet dhe shkarkohet me vendim të Administratorit në përputhje me Kodin e Punës, Statutin e shoqërisë si dhe aktet tjera të Ortakut të vetëm
- 22.2 Numri i punonjësve si dhe struktura organike e nivelit i pagave përcaktohen me vendim të Ortakut të vetëm mbi propozimin e Administratorit të shoqërisë
- 22.3 Administratori duhet të informojë Ortakun e vetëm jo më pak se një herë në muaj mbi numrin e të punësuarve në shoqëri

KREU IV

MBLEDHJET DHE VENDIMARRJA NË SHOQËRI

Neni 23

Aktet e Ortakut të vetëm

- 23.1 Ortaku i vetëm administron shoqërinë nëpërmjet akteve të ndryshme të miratuarar prej tij
- 23.2 Aktet duhet të jenë me shkrim si dhe të rregistrohet në një rregjistër të posaçëm
- 23.3 Në rastet e shqyrtimit të raporteve të Administratorit, të inventarit si dhe të miratimit të llogarive vjetore, Ortaku i vetëm njofton Administratorin dhe/ose likujdatorin, sipas rastit, jo më vonë se 10 ditë përpara datës së shqyrtimit.

KREU V

VITI FINANCIAR, RAPORTET VJETORE, FITIMI

Neni 24
Viti financiar

- 24.1 Llogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve e fitimit për shoqërinë bëhet cdo vit financiar
- 24.2 Cdo vit financiar fillon më datën 01 janar dhe mbyllt në datë 31 dhjetor.

Neni 25

Raportet vjetore

- 25.1 Administratori ose sipas rastit eksperti kontabël parqet raportet vjetore financiare jo më vonë se dymujori i parë i vitit financiar pasardhës
- 25.2 Raporti përban të dhëna mbi të ardhurat, shpenzimet si dhe çdo informacion tjetër financiar mbi shoqërinë
- 25.3 Ortaku i vetëm miraton raportet financiare dhe llogaritë vjetore të vitit financiar 8jo më vonë se 6 mujori i parë i vitit financiar pasardhës

Neni 26

Eksperti Kontabël

- 26.1 Emërimi i ekspertit kontabël bëhet nëpërmjet një akti me shkrim I cili I komunikohet personit të caktuar si ekspert kontabël I autorizuar
- 26.2 Eksperti kontabël emërohet për një periudhë prej 2 vitesh financiare duke përfshirë në këtë periudhë edhe vitin financiar në të cilin bëhet emërimi

Neni 27

Shkarkimi i Ekspertit kontabël

- 27.1 Eksperti kontabël shkarkohet me vendim të Ortakut të vetëm
- 27.2 Akti i shkarkimit duhet të bëhet me shkrim

Neni 28

Fitimi i shoqërisë

- 28.1 Fitimi i shoqërisë llogaritet në fund të cdo viti financier
- 28.2 Shpërndarja e fitimi bëhet me vendim të ortakut pasi është lënë më parë mënjanë rezerva e detyrueshme
- 28.3 Ortaku mund të disponojë lirisht fitimin e shoqërisë pasi të jenë lënë më parë mënjanë rezerva të detyrueshmë dhe të jenë shlyer të gjitha detyrimet që shoqëria ka kundrejt shtetit për këtë fitim

KREU VI

PRISHJA, SHPËRNADARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 29

Prishja e shoqërisë

- 29.1 Shoqëria mund të prishet me vendim të Ortakut të vetëm
- 29.2 Vendimi për prishjen e shoqërisë duhet të jetë me shkrim dhe duhet të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit

Neni 30

Shndërrimi i shoqërisë

- 30.1 Një shoqëri tregtare mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit si më poshtë:
 - a. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të shndërrohet në shoqëri aksionare dhe anasjelltas
- 30.2 Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve

Neni 31

Likujdimi i shoqërisë

- 31.1 Në rast falimentimi të shoqërisë, ajo kalon në process likujdimi
- 31.2 Shoqëria është në process falimentimi kur ajo është në pamundësi të pagesave ndaj të tretëve
- 31.3 Në procesin e likujdimit, Ortaku i vetëm ose gjykata cakton një likujdator, ekspert kontabël për të vlerësuar gjendjen financiare të shoqërisë

- 31.4 Procesi i likujdimit I paraqitur nga eksperti kontabël miratohet nga Ortaku I vetëm ose nga Gjykata
- 31.5 Në procesin e likujdimit shoqëria përfaqësohet nga likujdatori I cili është I autorizuar të paguajë të gjithë kreditorët në përputhje me rradhën e përcaktuar në legjislacionin shqiptar
- 31.6 Pas përfundimit të procesit të pagimit të kreditorëve, vlera financiare dhe kapitalet e tjera të shoqërisë, nëse ka, I dorëëzohen Ortakut të vetëm
- 31.7 Aktet e likujdimit në përfundim të tijsë bashku me llogaritë përkatëse depozitohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Pas kësaj shoqëria crregistrohet nga ky rregjistër

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 33

Ndryshimet në statut

- 33.1 Ky statut përbën dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së saj. Ky statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një statut të ri vetëm me vendim të Ortakut të vetëm.
- 33.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, ortakët do ti referohen legjislacionit tregëtar shqiptarnë fuqi si dhe praktikave tregtare në vend

Neni 34

Hyrja në fuqi

Ky statut është i hartuar në katër kopje në gjyhën shqipe dhe hyn në fuqi me miratimin dhe pranimin e depozitimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

ORTAKU THEMELUES

Z. Elton Muça